

PROCESVERBAL
nga seanca e 27-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 16.8. 2023

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës Kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, mr. Metodija Jançeski, L Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishmit nga Shërbimi profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, mr.Emilija Janevska, Goran Radunoviq, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë : /

Z. Petrushevski e hapi seancën e 27-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Z. Petrushevski në lidhje me propozimin e Rendit të ditës njoftoi se Pika nr.2 - Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 26-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 14.8.2023, për arsye teknike do të anulohet dhe do të vendoset për miratim para fillimit të seancës së ardhshme.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro" miratoi:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga Seanca e 5-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 14.8.2023 .
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 26-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 14.8.2023.
3. Propozim për iniciimin e procedurës për heqjen e licencës për transmetim televiziv për SHTR TELEVISION POLOG SHPKNJP Tetovë.
4. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë për shkelje të nenit 64 paragrafi (1) të LSHMAAV.
5. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 5-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 14.8.2023, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Z.Petrushevski, siç edhe njoftoi, për arsye teknike e anuloi Propozim-procesverbalin nga seanca e 26-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 14.8.2023.

Pika 3

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për iniciimin e procedurës për heqjen e licencës për transmetim televiziv për SHTR TELEVISION POLOG SHPKNJP Tetovë. Ai ka shpjeguar se ky transmetues edhe përkundër premtimit se do të kryejë pagesën në afatin e caktuar, të hënën, më 14 gusht nuk e ka kryer pagesën e kompensimit vjetor për licencën e transmetimit televiziv. Për këtë arsye, propozohet fillimi i procedurës për heqjen e lejes.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka inicuar procedurën për heqjen e licencës për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI POLOG SHPKNJP Tetovë, nr. 08-354, datë 30.6.2016, për shkelje të nenit 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21 dhe 154/23).

Sipas Raportit me shkrim për mbikëqyrjen e kryer administrative nr. 05-3163/1 datë 14.8.2023, transmetuesi nuk ka përbushur detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, gjegjësisht nuk ka paguar kompensimin vjetor për licencën e transmetimit televiziv, Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur nuk paguan kompensimin vjetor të licencës sipas faturës së lëshuar nga Agjencia, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI POLOG SHPKNJP Tetovë, nr.08-354 datë 30.6.2016.

Pika 4

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj SHTR K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë për shkelje të nenit 64 paragrafi (1) të LSHMAAV. Ai ka shpjeguar se ky transmetues, në kundërshtim me nenin e përmendur të Ligjit, nuk ka ofruar përkthim në gjuhën maqedonase në emisionin "Leskovačka roshtilijada 2014" për shkak se disa nga deklaratat e bashkëbiseduesve janë transmetuar burimisht (fillimisht) në gjuhën serbe, ndërsa licenca që i është dhënë është në gjuhën maqedonase. Për këtë arsye, për shkak të mos respektimit të dispozitave të LSHMAAV, propozohet që t'i shqiptohet masë vërejtje publike dhe urdhërohet që në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të mënjanon shkeljen, dhe pas skadimit të afatit të kryehet mbikëqyrje kontrolli.

Këshilli i Agjencisë ka shqyrtuar raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-2999/1 të datës 31.7.2023 dhe njëzëri konstatoi se ndaj SHTR K&M KISS&MENADA SHPKNJ Tetovë t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 64 paragrafi (1) të LSHMAAV për shkak se më 6 korrik 2023, në një emision nuk është ofruar përkthim në gjuhën maqedonase. Në emisionin "Leskovaçka Roshtilijada 2014" disa nga deklaratat e bashkëbiseduesve janë transmetuar fillimisht në gjuhën serbe, pa ofruar përkthim në gjuhën maqedonase.

Në pajtim me pikën 5 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprimin sipas akt vendimeve të Agjencisë për ndërmarjen e masave (teksti i pastruar) nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, është urdhëruar që në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat e nenit 64 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipërm duhet ta publikojë në ueb faqen e Agjencisë.

Pika 5

Të ndryshme

Nuk ka diskutim nën Të ndryshme.

Nr. 02-3170/4

29.08.2023

Shkup

Agjencia për Shërbime Mediatike

Audio dhe Audiovizuale

Kryetari i Këshillit,

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.